



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 24.02.2020)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për emërim në Gjykatën e Lartë, për kandidatin z. {...} dhe përjashtimin e tij nga procedurat e mëtejshme të kandidimit për pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr.108, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:19 dhe mbaroi në orën 14:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

10. Erjon Muharremaj (anëtar)

11. Marçela Shehu (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 6. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 7. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 8. Alsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 9. Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 10. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 11. Anisa Kuqi, EURALIUS.*
- 12. Rezart Alija, EURALIUS. (pika e fundit)*
- 13. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 14. Arlind Maloku, QE.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për emërim në Gjykatën e Lartë, për kandidatin z. {...} dhe përjashtimin e tij nga procedurat e mëtejshme të kandidimit për pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr.108, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Duke qenë që të gjithë anëtarët janë të pranishëm, fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 24.02.2020.

Siç jeni vënë në dijeni, në këtë mbledhje do merren në shqyrtim 3 çështje.

Çështja e parë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për emërim në Gjykatën e Lartë, për kandidatin z. {...} dhe përjashtimin e tij nga procedurat e mëtejshme të kandidimit për pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr.108, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Çështja e dytë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 26, datë 16.01.2020.

Dhe çështja e tretë ka të bëjë me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit Korçë.

Atëherë, le të fillojmë me çështjen e parë, relator i të cilit është zoti Alban Toro.

Alban Toro: Po! Faleminderit!

Meqenëse aktualisht relacioni është bërë i ditur të gjithë kolegëve, po jap në mënyrë të sintetizuar atë çka ai përmban.

Më herët, me vendimin nr. 108, 09.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është shpallur procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë në fushën e të drejtës administrative dhe në këtë kuadër, një nga kandidatët ka qenë edhe zoti {...}, i cili ka kandiduar edhe në këtë fushë.

Më pas edhe për këtë kandidat është kryer procedura e verifikimit për kushtet dhe kriteret ligjore, për të cilën, më pas, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me dy vendime të veçanta, me vendimin nr. 255, 12.11.2019 “Për kualifikimin e kandidatit jogjyqtar z. {...} dhe vijimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim si gjyqtar në Gjykatën e Lartë”, ka vendosur kualifikimin e tij dhe vijimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 108, datë 09.07.2019, të Këshillimit të Lartë Gjyqësor.

Më pas, me vendimin nr. 260, datë 13.11.2019 “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të

spikatur, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 108, datë 09.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, ky i fundit ka vendosur fillimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarë), për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 108, 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke caktuar edhe relatorin përkatës.

Në kuadër të procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë, relatori ka dërguar informacionin e nevojshëm kandidatit, duke e pyetur paraprakisht në lidhje me ekzistencën e kushteve përjashtuese për ndonjë nga anëtarët e Këshillit apo për vetë relatorin dhe në kuadër të konfirmimit, kandidati ka pohuar se nuk ka pasur një të tillë.

Kështu që më pas është vijuar me procedurën e kërkimit të dokumentacionit të nevojshëm, duke dërguar dhe duke administruar të gjithë aktet të cilat dispononte kandidati në kuadër të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së tij si kandidat potencial për Gjykatën e Lartë në fushën përkatëse.

Duke u mbështetur në dispozitat kushtetuese në ligjin specifik dhe në... Më pas, nga kandidati - më falni – kandidati, gjatë procedurave të vlerësimit të akteve të tij, me kërkesën 4666/3 prot., pranë Këshillin e Lartë Gjyqësor, me një shkresë të titulluar “Kërkesë për tërheqje nga kandidimi për vendin vakant të gjyqtarin të Gjykatës së Lartë në fushën e të drejtës administrative shpallur me vendim 108, 09.07.2019”, kandidati shfaq dëshirën të dorëhiqet nga kandidimi për pozicionin e lirë të shpallur për pozicionin administrativ.

Duke u mbështetur në dispozitat kushtetuese të ligjit specifik dhe aktet e tjera nënligjore të zbatueshëm për çështjen në shqyrtim si dhe nga aktet që janë të depozituara në dosjen personale të kandidatit, në mënyrë të veçantë aktin e dorëheqjes, vlerëson se procedura e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë dhe procedurat e mëtejshme e kandidimit për pozicionin e lirë, në fushën e së drejtës administrative, të këtij të fundit ndërpriten për shkak të dorëheqjes së tij.

Bazuar në faktin e tërheqjes nga kandidimi, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se një tërheqje e tillë është e drejtë ligjore e kandidatit {...} e sanksionuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu V, të vendimit të tij nr.102, 05.07.2019, “Mbi kriteret e

vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”.

Konkretisht, sipas pikës 8, Seksioni B, Kreu V, të këtij vendimi, “Kandidati ka të drejtë të tërhiqet nga kandidimi derisa Këshilli nuk ka përfunduar procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për emërim, duke njoftuar për këtë, me shkrim, Këshillin. Pas këtij njoftimi, me propozim të relatorit të çështjes, përcjellë nga Komisioni, Këshilli vendos menjëherë përfundimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për emërim për këtë kandidat dhe përjashtimin nga procedurat e mëtejshme të kandidimit. Akti i Këshillit për përfundimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për emërim të këtij kandidati dhe përjashtimin e tij nga procedurat e mëtejshme të kandidimit, i njoftohet menjëherë kandidatit dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit”.

Konkretisht, në këtë rast është mbajtur parasysh përcaktimi i bërë në nenin 94, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”. Komisioni në zbatim të drejtë të dispozitave ligjore dhe atyre nënligjore të zbatueshëm në rastin e dorëheqjeve gjatë kandidimit vlerëson të rregullt qartësinë e vullnetit të shprehur, me aktin nr. 4666/3 prot., datë 20.02.2020, prej këtij kandidati dhe si të tilla e konsideron atë si një të drejtë që ushtrohet nga ai në çdo moment dhe që bazohet ekskluzivisht mbi vullnetin individual të tij duke respektuar procedurat, kushtet dhe kriteret e kandidimit që parashikojnë aktet rregullative të sipërcituara. Në çdo fazë e gjendje procedimi administrativ, kur kandidati shpreh vullnetin për të mos vijuar më tek konkurrimin, nuk ka vend për të vijuar më tej procedurat e vlerësimit, të pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës të parashikuara nga dispozitat ligjore dhe aktet e nxjerra në zbatim të tyre.

Në referim të situatës së faktit dhe parashikimeve të sipërcituara të vendimit 102, datë 05.07.2019, Komisioni vlerëson se jemi në kushtet e përfundimit të procedurës së përzgjedhjes së kandidatit për emërim në Gjykatën e Lartë për pozicionin e lirë, në fushën e së drejtës administrative, z. {...}.

Duke e vlerësuar të plotë procedurën dhe verifikimet e kryera për kandidatin z. {...}, relatori i çështjes ia parashit rastin Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Në Mbledhjen e datës 20.02.2020, Komisioni, duke konsideruar se procedurat dhe verifikimet ishin të plota, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu V, të vendimit të tij nr.102, datë 05.07.2019, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur përfundimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për emërim në Gjykatën e Lartë, për kandidatin z. {...} dhe përjashtimin e tij nga procedurat e mëtejshme të kandidimit për pozicionin e lirë, në fushën e së drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr.108, datë 09.07.2019.

Në këtë kontekst është përgatitur edhe një draft vendimi, në dispozitivin e të cilit është përcaktuar se: Këshilli vendosi përfundimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për emërim në Gjykatën e Lartë, për kandidatin {...} dhe përjashtimin e tij nga procedurat e mëtejshme të kandidimit për pozicionin e lirë, në fushën e së drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr.108, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 5 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky ishte materiali i përgatitur. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toro!

Kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin e propozuar?

Nëse jo, kalojmë në votim të projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga zoti Toro dhe Komisioni? Fillimisht do kalojë votimin, sipas rregullores e ka relatori, Komisioni dhe më pas Këshilli.

Alban Toro: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Maksim Qoku: Dakord.

(Vota e zonjës Kadi nuk dëgjohet.)

Dritan Hallunaj: Pro.

Fatmira Luli: Pro.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Përfundimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për emërim në Gjykatën e Lartë, për kandidatin z. {...} dhe përjashtimin e tij nga procedurat e mëtejshme të kandidimit për pozicionin e lirë, në fushën e së drejtës administrative, shpallur me vendimin nr.108, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, i ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 5 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 24.02.2020)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.26, datë 16.01.2020.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:19 dhe mbaroi në orën 14:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Erjon Muharremaj | (anëtar) |
| 11. Marçela Shehu | (anëtare) |

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. ***Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.***
2. ***Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***
3. ***Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***
4. ***Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.***
5. ***Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.***
6. ***Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.***
7. ***Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.***
8. ***Alsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.***
9. ***Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.***
10. ***Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.***
11. ***Anisa Kuçi, EURALIUS.***
12. ***Rezart Alija, EURALIUS. (pika e fundit)***
13. ***Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.***
14. ***Arlind Maloku, QE.***

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.26, datë 16.01.2020.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen e dytë të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.26, datë 16.01.2020. Relatimi i projekt-aktit do të bëhet nga zoti Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur një projektvendim për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 26, datë 16.01.2020. Ky vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor, pra vendimi nr. 26, datë 16.01.2020 është marrë mbështetur në nenet 4, pika 3, nenin 147, pika 1 dhe nenin 147/a, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenet 2 dhe 89 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në kushtet kur Gjykata e Apelit Korçë ishte jashtë funksioni për shkak të mungesës së numrit minimal të gjyqtarëve në detyrë, vetëm dy gjyqtarë. Ndërkohë, me vendimin nr.74, datë 20.02.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi: “Komandimin e gjyqtarës znj.{...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një afat 2-vjeçar”.

Më tej, me vendimin nr.75, datë 20.02.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi: “Gjyqtarja e skemës së delegimit znj.{...} caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Korçë për periudhën deri më datë 15.09.2020”.

Si pasojë e vendimmarrjeve si më lart të Këshillit të Lartë Gjyqësor, aktualisht është bërë e mundur që në Gjykatën e Apelit Korçë të jenë në detyrë tre gjyqtarë, çka është një rrethanë për të cilën Këshilli duhet të rishikojë vendimin e tij nr.26, datë 16.01.2020.

Në situatën aktuale, Gjykata e Apelit Korçë mund të përmbushë nevojat imediate në ato çështje për të cilat të tre gjyqtarët në detyrë nuk kanë shkaqe papajtueshmërie për ushtrimin e funksionit, përfshirë edhe për çështjet urgjente, sipas shkronjës “a”, pika 1, të vendimit nr.26, datë 16.01.2020, pra ato që kanë të bëjnë me caktim, zëvendësim, revokim, bashkim ose shuarje të masave të sigurimit në lëndë penale.

Nisur nga kjo, mbështetur në nenet 113 dhe 117 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në nenin 90 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, është vendi për ndryshimin e shkronjës “b”, pika 1, të vendimit nr.26, datë 16.01.2020, sa kohë rregullimi i parashikuar në të lidhet edhe me situatën e mungesës së numrit minimal të gjyqtarëve në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë.

Për të evituar konfondimin që krijohet mes efekteve të shkronjës “b”, pika 1, të

vendimit nr.26, datë 16.01.2020, me ato të vendimit nr.75, datë 20.02.2020, Komisioni vlerëson se një gjë e tillë mund të arrihet përmes riformulimit të shkronjës “b”, pika 1, të vendimit nr.26, datë 16.01.2020, duke vlerësuar që lista e gjyqtarëve të gjykatave të apelit, miratuar me vendimin e tij nr.27, datë 16.01.2020, duhet të vijojë të jetë efektive, por kjo vetëm për rastet kur për gjyqtarin në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë konstatohen, sipas ligjit, shkaqe papajtueshmërie në çështje të veçanta. Mbajtja në fuqi e rregullimit për këtë situatë vijon të jetë ende e nevojshme sa kohë ekziston mundësia që për gjyqtarin në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë të konstatohen, sipas ligjit, shkaqe papajtueshmërie në çështje të veçanta, rrethanë që do të çonte në daljen jashtë funksionit të Gjykatës së Apelit Korçë në ato raste. Në vlerësim të Komisionit, mbajtja e këtij rregulli do të shmangte vonesat në caktimin rishtazi të gjyqtarëve nga gjykatat e tjera të apeleve për çështjet në nevojë në Gjykatën e Apelit Korçë, përveç se, gjyqtarëve të listës së miratuar tashmë, do t’iu mundësonte planifikimin e aktiviteteve të tyre, çka edhe kjo do të shmangte vonesat në gjykimin e atyre çështjeve të veçanta.

Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.26, datë 16.01.2020”, ku sipas pikës 1 të tij propozohet që shkronja “b”, e pikës 1, të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 26, datë 16.01.2020, “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, në lidhje me nevojat e Gjykatës së Apelit Korçë”, riformulohet si më poshtë:

“b) Për çështjet sipas shkronjës “a” të këtij vendimi, në rastin kur për gjyqtarin në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë konstatohen, sipas ligjit, shkaqe papajtueshmërie në çështje të veçanta, trupi gjykues formohet me gjyqtarin që gjendet i renditur në listën e miratuar nga Këshilli. I njëjti rregull zbatohet edhe në rastin kur për gjyqtarët në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë konstatohen, sipas ligjit, shkaqe papajtueshmërie në çështje të veçanta. Në këtë rast, krahas gjyqtarit të caktuar për periudhën respektive, trupi gjykues formohet edhe nga gjyqtari apo gjyqtarët që gjenden të renditur më pas në listën e miratuar nga Këshilli. Kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Korçë merr masa për

njoftimin në kohë të gjyqtarit/gjyqtarëve zëvendësues”.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet që vendimi i njoftohet gjykatave të apelit.

Dhe së fundi, në projektvendim parashikohet dhe hyrja e tij në fuqi, pikërisht menjëherë dhe ai botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin e propozuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës?

Nëse jo, kalojmë në votim projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga Komisioni?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Shkronja “b”, e pikës 1, të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 26, datë 16.01.2020, “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.30, datë 14.02.2016 (është lapsus viti 2016, duhet 2019), “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, në lidhje me nevojat e Gjykatës së Apelit Korçë”, riformulohet si më poshtë:

“b) Për çështjet sipas shkronjës “a” të këtij vendimi, në rastin kur për gjyqtarin në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë konstatohen, sipas ligjit, shkaqe papajtueshmërie në çështje të veçanta, trupi gjykues formohet me gjyqtarin që gjendet i renditur në listën e

miratuar nga Këshilli. I njëjti rregull zbatohet edhe në rastin kur për gjyqtarët në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë konstatohen, sipas ligjit, shkaqe papajtueshmërie në çështje të veçanta. Në këtë rast, krahas gjyqtarit të caktuar për periudhën respektive, trupi gjykues formohet edhe nga gjyqtari/gjyqtarët që gjenden të renditur më pas në listën e miratuar nga Këshilli. Kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Korçë merr masa për njoftimin në kohë të gjyqtarit/gjyqtarëve zëvendësues.

Ky vendim i njoftohet gjykatave të apelit; Dhe hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 24.02.2020)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit Korçë dhe Gjykatën e Lartë (e cila shtohet gjatë shqyrtimit të kësaj pike).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:19 dhe mbaroi në orën 14:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Erjon Muharremaj | (anëtar) |
| 11. Marçela Shehu | (anëtare) |

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
6. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
7. *Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
8. *Alsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
9. *Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
10. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
11. *Anisa Kuçi, EURALIUS.*
12. *Rezart Alija, EURALIUS. (pika e fundit)*
13. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
14. *Arlind Maloku, QE.*

RENDI I DITËS:

3. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit Korçë dhe Gjykatën e Lartë (e cila shtohet gjatë shqyrtimit të kësaj pike).

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen e fundit të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit Korçë. Prapë fjalën e ka zoti Toska.

Ilir Toska: Atëherë, do duhet të shtojmë në rendin e ditës edhe një relacion që ka të bëjë me Gjykatën e Lartë që erdhi ditën e sotme. Bëhet fjalë për dy çështje që kanë të bëjnë me ekstradimin.

Dhe e dyta është që sapo më njoftuan administrata që pajisja teknike që na mundëson shortin elektronik ka një problem dhe sa ta riparojnë, duhet të bëjmë pak pauzë.

(Anëtarët e Këshillit bëjnë një pauzë.)

Naureda Llagami: Atëherë, rifillojmë mbledhjen.

Sërish ia jap fjalën zotit Toska!

Ilir Toska: Mirë atëherë! Do duhet të përfshijmë në rendin e ditës edhe çështjet në nevojë të Gjykatës së Lartë që ta përfshijmë brenda kësaj pike të rendit të ditës, sepse tek materialet që dërguam më herët nuk ishte kjo e përfshirë. Ishte vetëm Gjykata e Apelit Korçë. Dhe pas kërkesës së bërë nga Gjykata e Lartë, u përgatit edhe materiali për Gjykatën e Lartë.

Jeni dakord?

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në votim?

Jeni dakord?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Ilir Toska: Mirë atëherë, fillojmë me hedhjen për sa i përket çështjeve në nevojë në Gjykatën e Apelit Korçë.

Gjykata e Apelit Korçë ka paraqitur nevojë në 146 çështje deri në datë 21 shkurt të vitit 2020.

Në materiale, në relacionin që keni përpara, janë të evidentuara të gjitha çështjet në nevojë të Gjykatës së Apelit Korçë.

Kërkesat si më lart të Gjykatës së Apelit Korçë janë bërë në kushtet kur Këshilli i Lartë Gjyqësor ende nuk kishte marrë vendimin nr. 74, datë 20.02.2020 “Për komandimin e gjyqtarës znj.{...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një afat 2-vjeçar”, si dhe vendimin nr.75, datë 20.02.2020, me të cilin “Gjyqtarja e skemës së delegimit znj.{...} caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Korçë për periudhën deri më datë 15.09.2020”.

Për rrjedhojë, nevojat për 131 nga kërkesat si më lart të Gjykatës së Apelit Korçë, konkretisht ato me numër rendor 1 - 50, si dhe 59 - 139, aktualisht nuk ekzistojnë më, pasi nevoja për caktimin e 1 gjyqtari në çështjet respektive plotësohet përmes caktimit të gjyqtarës së skemës së delegimit, znj.{...}.

Për të njëjtën arsye, nevojat për 15 kërkesat e tjera si më lart të Gjykatës së Apelit Korçë, ato me numër rendor 51 - 58, si dhe 140 - 146, aktualisht ekzistojnë në një masë më të vogël, pra për një gjyqtar më pak.

Në këto kushte, 131 kërkesat si më lart të Gjykatës së Apelit Korçë tashmë kanë mbetur pa objekt, prandaj është vendi që Këshilli të vendosë për deklarimin e përfunduar të çështjes pa një vendim përfundimtar, bazuar në nenin 90/3 dhe 95 të Kodit të Procedurave Administrative, Kod rregullimet e të cilit duhet të zbatohen nga Këshilli në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes si sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, sikurse përcakton neni 97/3 i tij.

Po me të njëjtin arsyetim, edhe 15 kërkesat e tjera si më lart të Gjykatës së Apelit Korçë tashmë kanë mbetur pa objekt sa i përket kërkimit të caktimit të 1 gjyqtari.

Sipas nenit 90/3 të Kodit të Procedurave Administrative, “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për

çështjen, përbën akt administrativ”.

Ndërsa sipas nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative, “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”.

Kurse sipas nenit 97/3 të ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes si sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, “Këshilli i Lartë Gjyqësor zbaton Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga ky ligj”.

Nisur nga rrethanat si më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë:

Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të 131 kërkesave për caktimin e një gjyqtari. Dhe evidentohen të 131 kërkesat përkatëse.

Ndërkohë, për 15 çështjet e tjera, ato me numër rendor 51 - 58, si dhe 140 – 146, nevojat e Gjykatës së Apelit Korçë nuk mund të plotësohen përmes skemës së delegimit, sipas nenit 45 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe rregulloren e Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit” për shkak të padisponueshmërisë, mungesës së gjyqtarëve të tjerë në skemë delegimi, përveç asaj që ne tashmë e kemi caktuar në Gjykatën e Apelit Korçë, zonjën {...}.

Po kështu, për këtë kategori kërkesash është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, për rrjedhojë është i aplikueshëm zbatimi i mekanizmit të caktimit të gjyqtarit “Për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Ndërkohë, referuar edhe vendimit nr. 30, datë 14.02.2019, i përshtatur sa i përket nevojave të Gjykatës së Apelit Korçë me vendimin nr.26, datë 16.01.2020, në të cilin ka përcaktuar dhe mënyrën e operimit nga Këshilli për kërkesat e kësaj gjykate, varësisht nga shkalla e urgjencës sipas afateve ligjore për kategori të caktuara çështjesh., nga 15 kërkesat që ne mund të operojmë për caktimin e një gjyqtari, sipas skemës së miratuar nga Këshilli, do duhet të procedojmë menjëherë vetëm për 12 nga këto kërkesa,

konkretisht për kërkesat me numër rendor 51 - 53, 55 - 56, 58 (që janë në lëndë penale) si dhe për çështjet civile, ato me numër rendor 140 - 143 dhe 145 – 146.

Për tre kërkesa, ato me numër rendor 54, 57 dhe 144, Këshilli i Lartë Gjyqësor do duhet të procedojë në një kohë të dytë, brenda afateve të arsyeshme, kjo nisur nga momenti i regjistrimit të këtyre çështjeve, fakti që nuk janë të paraburgosur (dy çështje në lëndë penale), ndërsa çështja civile është regjistruar vetëm në dhjetor të vitit 2019.

Në konsideratë të kriterëve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor për caktim gjyqtari në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, për 12 çështje, ka këto propozime:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 12 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë Gjykata e Apelit Tiranë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 4.

Propozimet vijuese janë: Për 6 çështjet civile, ato nr.140, nr.141, nr.142, nr.143, nr.145, dhe nr.146, për të cilat kërkohen 1 dhe 2 gjyqtarë, të caktohen 2 të tillë, të cilët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Seksionit Civil të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Ndërsa për 6 çështjet penale, ato nr.51, nr.52, nr.53, nr.55, nr.56, dhe nr.58, për të cilat kërkohen 1 dhe 2 gjyqtarë, të caktohen 2 të tillë, të cilët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Propozime të tjera ka Komisioni për sa i përket përjashtimeve nga shorti, konkretisht: të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Tiranë, konkretisht: z.Ridvan Hado.

Të përjashtohen nga shorti gjyqtarët me leje afatgjatë nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë: znj. Evjeni Sinojmeri dhe z. Gjin Gjoni.

Po kështu, në shortimin e këtyre çështjeve civile të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Seksionit Civil të Gjykatës së Apelit Tiranë që u caktuan, në shortin e datës 20.02.2020, për të gjykuar çështje gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë dhe në Gjykatën e Apelit Shkodër, konkretisht: znj.Flutura Skënderi, znj.Elona Toro, znj.Elbona Lluri, z.Gramoz Levanaj, z.Artur Gaxha.

Ndërsa në shortimin e çështjeve penale përjashtohen nga shorti gjyqtari i

Seksionit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë që u caktua, në shortin e datës 20.02.2020, për të gjykuar çështje gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit Shkodër, konkretisht: z.Alaudin Malaj.

Tani ftoj Këshillin, referuar propozimeve që ka bërë Komisioni, t'i miratojë ose jo dhe të procedojmë më tej.

Atëherë, për propozimin e parë për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar, pra 131 çështje. A jeni dakord.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Ilir Toska: Për propozimet e tjera sa i përket shortimit vetëm të 12 çështjeve, pra jo të 15. 3 çështje të mbeten në pritje, t'i bëjmë në një kohë të dytë. Jeni dakord?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Ilir Toska: Me propozimet që ka bërë Komisioni për shpërndarjen e 12 çështjeve, jeni dakord?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Ilir Toska: Atëherë, vazhdojmë me procedurën e shortit elektronik., meqenëse Këshilli është dakord me propozimet e Komisionit.

Valbona Bako: Sipas propozimit të parë, për çështjen nr. 142 përzgjidhet gjyqtare Maria Qirjazi.

Për çështjen nr. 141 gjyqtare Edlira Petri.

Për çështjen nr. 143 Maria Qirjazi dhe Edlira Petri.

Për çështjen nr. 145 Maria Qirjazi dhe Edlira Petri.

Për çështjen nr. 146 gjyqtaret Maria Qirjazi dhe Edlira Petri.

Për çështjen nr. 140 gjyqtaret Maria Qirjazi dhe Edlira Petri.

Sipas propozimit të dytë, për çështjen nr. 53 gjyqtarët Shpresa Beçaj dhe Shkëlqim Mustafa.

Për çështjen nr. 52 gjyqtare Shpresa Beçaj.

Për çështjen nr. 55 gjyqtarët Shkëlqim Mustafa dhe Shpresa Beçaj.

Për çështjen nr. 51 gjyqtari Shkëlqim Mustafa.

Për çështjen nr. 56 gjyqtarët Shpresa Beçaj dhe Shkëlqim Mustafa.

Për çështjen nr. 58 gjyqtarët Shpresa Beçaj dhe Shkëlqim Mustafa.

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Korçë.

Vazhdojmë me relacionin sa i përket Gjykatës së Lartë. Ka paraqitur nevojë në 2 çështje penale. Të dyja janë me objekt “Lejim ekstradimi” në lëndë penale.

Në një rast kërkohen 3 gjyqtarë dhe në një rast tjetër kërkohen 2 gjyqtarë.

Edhe në këtë rast është i aplikueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni ka këto propozime:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështje gjyqësore të veçanta, të jenë gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm dhe Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Gjyqtarët për 2 çështje gjyqësore të veçanta, të përzgjidhen, me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështje gjyqësore të veçanta, të jetë 3.

Në opsionin e pranimit të këtij propozimi do duhet të bëjmë short elektronik për shpërndarjen e dy çështjeve mes 10 gjyqtarëve që plotësojnë kriteret e përcaktuara si më lart, që janë: Nertina Kosova - Gjykata e Apelit për Krime të Rënda; Albana Boksi - Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda; Dhimiter Lara - Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda; Enton Dhimitri - Gjykata e Apelit Gjirokastër; Margarita Buhali - Gjykata e Apelit Vlorë; Saida Dollani - Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda; Sokol Binaj - Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda; Artur Kalaja - Gjykata e Apelit Tiranë; Astrit Kalaja - Gjykata e Apelit Shkodër; Dritan Banushi - Gjykata e Apelit Gjirokastër.

Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord! Vazhdojmë atëherë, meqenëse Këshilli është dakord me procedurat e shortit elektronik.

Valbona Bako: Atëherë, për çështjen e parë që kërkohen 3 gjyqtarë, përzgjidhen gjyqtarët Albana Boksi (relatore) dhe anëtarë Dhimitër Lara dhe Nertina Kosova.

Për çështjen nr. 2 janë gjyqtarët Albana Boksi dhe Dhimitër Lara.

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit.

Atëherë, nëse s'keni gjë tjetër, mbledhjen e konsideroj të mbyllur.

Faleminderit për prezencën!

Punë të mbarë!

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor